



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

PROGRAMI I STUDIMIT



KËRKIMI SHKENCOR




SHËRBIMI PER TE TRETE



## PROGRAMI

# PERMIRESIMI I CILESISE NE AKTIVITETET E UPT

(2009 - 2011)



DOKUMENTI 2/5

Tirane, 2009



**2009 - 2011**  
DREJT STANDARDEVE  
EVROPIANE TE CILESISE



## **PROCESI SENSIBILIZUES-INFORMUES I PROGRAMIT**

**Fushata Sensibilizuese-Informuese**  
Shkurt - Mars 2009

DRAFT

---

<b>PERMBAJTJA</b>	<b>Faqja</b>
<b>Pjesa 1-re: Te pergjithshme</b> .....	2
Dy fjale mbi fushaten e sensibilizim-informimit .....	2
Qellimi i Procesit PSI .....	3
Objektivi i pergjithshem i Procesit PSI .....	3
Objektivi metodologjik .....	3
Kohezgjatja e Procesit Psi .....	3
<b>Pjesa 2-te: Aktivitetet e menaxhimit te Procesit te Sensibilizim- Informimit</b> .....	4
Aktivitetet e planifikimit te Procesit PSI .....	4
Aktivitetet e realizimit te Procesit PSI .....	6
Aktivitetet e kontrollit te realizimit te Procesit PSI .....	7
Veprimet permiresuese pas realizimit te Procesit PSI.....	8
<b>Pjesa 3 te: Dokumente permbledhes</b> .....	9
Kuadri Logjik i Procesit PSI .....	10
Plani kalendar i aktiviteve te Procesit PSI .....	11
Evidenca e realizimiti dhe kontrollit te aktiviteve te Procesit PSI .....	12
List-pagesa e kontribuesve ne aktivitetet e Procesit PSI .....	13
List-shpenzime ne aktivitetet e Procesit PSI .....	14

## PJESA 1-RE: TE PERGJITHSHME

### DY FJALE PER FUSHATEN E SENSIBILIZIM-INFORMIMIT

Çdo aktivitet, sado i madh ose i vogël, pavaresisht nga lloji i fushes se veprimtarise njerezore, ka nevoje qe te paraprihet nga sensibilizimi jo vetem i pjesemarresve te drejtperdrejte, por dhe i paleve te tjera te interesuara per te, ne kuptimin dhe interesin e asaj qe mund te perfaqesohet nga shprehja: “fillimi i mbare, gjysma e punes”.

Kujtojme se koncepti sensibilizim apo ndjeshmeri eshte aftesia e njeriut per te kapur “ngacmimet” e jashtme dhe per t’u pergjigjur atyre ne nje shkalle te larte. Pikerisht permbajtja e ketij koncepti eshte parashikuar si nje startues i domosdoshem per aktivitetet qe do te zhvillohen, aktivite qe do te kerkojne pjesemartjen e te gjithë personelit te institucionit me ndjeshmerine, pergjegjesine, perkushtimin dhe disiplinën e nevojshme per te arritur objektivat e caktuara.

Ne rastin e Programit te ndermarre dhe te titulluar “Permiresimi i cilesise ne aktivitetet e UPT”, natyrisht qe vemendja terhiqet, fokusohet tek gjendja aktuale e cilesise ne Universitetin Politeknik te Tiranes.

Argumenti i cilesise nuk mund te konsiderohet i ri, befasues per stafin akademik, per ate ndihmes dhe per studentet e ketij institucioni. Por duke mos u trajtuar ne masen, menyren dhe kohen e duhur, eshte krijuar nje gjendje ne te cilen ky argument “fle” apo ne rastin me te mire “ecen e zhvillohet vete”, ndofta ne nje kahje te padeshiruar. Nder faktoret qe kane ndikuar ne krijimin e kesaj gjendje, dhe qe mund te tipizojne ate, po permenden:

- Konceptet themelore qe lidhen me cilesine ne arsimin e larte dhe me trajtimin e saj ne fushen e menaxhimit institucional pothuaj nuk njihen nga personeli i UPT, megjithate
- cilesia, keto dy dekadat e fundit, ka qene dhe eshte objekt diskutimeve spontane ne nivelet e ndryshme hierarkike, ne grupet e stafeve, ne rrethet e ngushta pedagogesh apo laborantesh, por per te eshte folur “si nen ze”, gjithmone ne kuptimin e saj te pergjithshem dhe jo shume konkret, eshte folur shkurt, si diçka qe po “u ha kohen (shpesh here) kot, sepse
- ne pergjithesi, mbizoteron nje fare pesimizmi per suksesin ne trajtimin e cilesise ne aktivite qe zhvillohen ne UPT, i cili ushqehet edhe nga
- idea, shpesh mbizoteruese tek personeli, se qe te permiresosh cilesine kerkohen shpenzime qe mund te perballohen vetem me fonde shume te medhenj.
- Pergjithsisht, te gjithë antaret e stafeve, posaçerisht te stafeve akademike, presin ndonje gje nga drejtuesit, ndersa drejtuesit e te gjitha niveleve sikur jane “ne pritje te inisiativave te marra nga lart” ne drejtim te cilesise.
- Konkurenca e brendshme, si nje nga argumentet qe eshte lidhur sot, ne kushtet e ekonomise se tregut, pazgjidhshmerisht me cilesine edhe te sherbimeve te institucioneve te ndryshme, duke perfshire dhe ata te arsimit te larte, pothuaj nuk eshte e pranishme ne grupin e elementeve promotore te zhvillimit (UPT eshte Institucioni i vetem ne Arsimin te Larte Shqiptar qe ofron diploma inxhinierike).

Edhe vetem keta faktore, bejne te domosdoshme sensibilizimin e nje “ambienti qe pothuaj fle” dhe qe eshte e nevojshme jo vetem te “zgjohet”, por sidomos te sqarohet drejt, objektivisht, me transparence dhe me argumente te fuqishem, qe te kete vizion te qarte dhe ne nje kohe sa me te shkurter te jete gati per t’iu kthyer evidentimit, formulimit, dhe pergatitjes per zgjidhjen e problemeve te akumuluar dhe te lidhur me prapambetjen relative te cilesise ne UPT. Ne kete menyre, eshte parashikuar se sensibilizimi do te “injektoje” dozen e nevojshme te sigurise dhe te optimizmit tek personeli i UPT dhe do te krijojë kushtet e nevojshme per mobilizimin e tyre te metejshem.

Nga ana tjetër, faktoret e mesipër do të jenë ndër faktoret që do të ndikojnë dhe në përmbajtjen e anës teknike, mbështetëse, të sensibilizimit, që do të shprehet në informacionet e ndryshme (në thellesinë dhe gjerësinë që kërkon dhe lejon procesi i sensibilizimit), për të cilat mendohet se ka nevojë personeli i UPT në këto faza të zhvillimit të Programit, ndërmjet të cilëve le të përmendim informimin e shkurtër për objektivat, linjen llogjike dhe përmbajtjen e tre projekteve që përbejnë bazën e këtij aktiviteti shumëvjeçar kompleks.

Fushata sensibilizuese-informuese dhe menaxhimi i saj në një plan të gjërë institucional, do të jetë procesi dhe përvoja e parë që ndërmerret dhe fiton UPT për zgjidhjen e problemit të përmirësimit të cilësive në aktivitetet që zhvillon ky institucion, problem i cili është dhe do të jetë problemi kryesor dhe më i rëndësishëm i tij.

### **QELLIMI I PROCESIT PSI**

Ky Proces sensibilizimi synon që nëpërmjet forma të ndryshme të tij, të cilat kanë informacionin e nevojshëm, të krijojë një ambient të përgjithshëm të ndjeshëm dhe një gjendje të tillë të personelit, e cila të karakterizohet nga ndergjegjësimi, përgjegjësia, optimizmi dhe gadishmeria për veprim, të nevojshëm këto për zhvillimin me sukses të tre projekteve pasardhës të Programit, në të cilat do realizohen një numër aktivitetesh dhe nëaktivitetesh që lidhen me vendosjen dhe vlerësimin e një niveli zyrtar të pranueshëm të cilësive në aktivitetet që ofron UPT: mesimdhënia, kërkimi shkencor dhe shërbimet për të tretë.

### **OBJEKTIVI I PËRGJITHSHEM I PROCESIT PSI**

Realizimi i sensibilizim-informimit të nevojshëm me të gjithë masën e personelit të strukturës organizative të UPT dhe të gjithë masën e studentëve të këtij institucioni.

### **OBJEKTIVI METODOLOGJIK**

Krijimi i traditës që çdo aktivitet i rëndësishëm të paraprihet nga sensibilizimi dhe informimi përkatës.

### **KOHEZGJATJA E PROCESIT PSI**

Kohezgjatja e Procesit PSI është afër 4 muaj: dhjetor 2008 deri në mars 2009. Por realisht kjo periudhë do të shtrihet edhe në periudhën pasuese, deri në fund të Programit, natyrisht në formë dhe përmbajtje të ndryshme.

Periudha dhjetor 2008 – janar 2009 është parashikuar si periudha përgatitore e Procesit PSI, ndërsa periudha shkurt – mars 2009 do të jetë periudha e zhvillimit të sensibilizimit në të gjithë masën e personelit dhe të studentëve të UPT.

## PJESA 2-TE: AKTIVITETET E MENAXHIMIT TE PROCESIT TE SENSIBILIZIM- INFORMIMIT

### 1. Aktivitetet e planifikimit te Procesit PSI

#### 1.1 Grupet e realizimit te Procesit PSI

##### 1.1.1 Krijimi i grupeve sensibilizuese

Krijimi i grupeve sensibilizuese duhet te behet duke patur parasysh se problemi i permiresimit te cilesise eshte bere sot si problemi kryesor dhe me i rendesishem i UPT dhe duke respektuar parimin e perfshirjes se nje numri sa me te madh te mundshem pjesemarresish ne ndertimin dhe implementimin e Programit. Mbi kete baze ne grupet e punes qe do te realizojne Procesin PSI detyrimisht duhet te parashikohen perfaqesues qe nga nivelet me i larte ekzekutive te UPT: Rektorati dhe dekanatet/drejtorite e te gjitha fakulteteve/instituteve, e deri tek perfaqesuesit e bazes. Nga ana tjeter pjesemarrja e studenteve duhet te konsiderohet sa e dobishme aq dhe e domosdoshme.

Ne grupet e krijuara, si dhe brenda grupit, duhet te vendoset nje hierarki, ne perputhje me pozicionet e perfaqesuesve dhe detyrat e tyre ekzekutive.

Krijimi i ketyre grupeve do te kryhet nga ana e Rektorit te UPT.

Indikatori i performances se ketij nenaktiviteti do te jete: “Skema e grupeve sensibilizuese te procesit PSI”.

##### 1.1.2 Trainimi i grupeve sensibilizuese

Grupi qendror dhe grupet e fakulteteve/instituteve/studenteve te krijuara per realizimin e aktiviteve dhe nenaktiviteve te Procesit PSI do te trainohen, me qellim qe ata te sensibilizohen te paret, te zgjerojne njohurite teknike te fushes se cilesise dhe te informohen per projektet e Programit qe do te ndermarre UPT. Meqenese do te kene detyra disi te diferencuara trainimi i tyre do te kryhet vecmas.

Trainimi i grupit qendror do te jete relativisht i shkurter. Problematika e trainimit te grupit kryesor duhet te jete e tille qe pjesetaret e ketij grupi te jene ne gjendje qe:

- te kuptojne konceptet themelore te cilesise dhe te menaxhimit te cilesise ne universitet;
- te arrijne te formulojne Deklaraten Sensibilizuese te Rektoratit, si dokumenti baze per Procesin PSI;
- te ndertojne planin kalendar te takimeve sensibilizuese ne dekanatet/drejtorite e fakulteteve dhe instituteve;
- te drejtojne dhe kontrollojne nengrupet ne realizimin e detyrave te tyre sensibilizuese - informuese.

Ndersona trainimi i grupeve te fakulteteve/instituteve/studenteve do te jete dy ditor. Problematika e ketij trainimi duhet te jete me e gjere dhe me e thelle ne drejtim te elementeve sensibilizues dhe ne drejtim te problemeve teknike te cilesise. Nepermjet trainimit anetaret e ketyre grupeve duhet te jene te pergatitur per:

- Kuptimin e koncepteve themelore te cilesise ne arsimin e larte universitar.
- Hartimin e materialit sensibilizues-informues baze, qe do te paraqitet ne mbledhjet apo takimet qe do te organizohen me grupet e punonjesve te fakulteteve/instituteve (stafet

- akademike dhe ndihmes te departamenteve, punonjesit e administrates se fakulteteve/instituteve, punonjesit e sherbimeve) dhe grupet e studenteve te fakulteteve.
- Pergatitjen e planeve kalendare te mbledhjeve apo takimeve qe do te organizohen me grupet e punonjesve te fakulteteve/instituteve dhe grupet e studenteve te fakulteteve.

Ky nenaktivitet do te kryhet me kontributin e konsulentit teknik te cilesise dhe te kryetareve te grupeve te punes sensibilizuese.

Indikatorret e performances se ketij nenaktiviteti do te jene:

- Materiali i paraqitur ne trainimin e grupit kryesor (ne slajde).
- Deklarata sensibilizuese e Rektoratit.
- Plani kalendar i takimeve sensibilizuese ne dekanatet/drejtorite e fakulteteve dhe instituteve.
- Plani kalendar i kontrollit te aktiviteteve apo nenaktiviteteve te Procesit PSI.
- Materiali i paraqitur ne trainimin e grupeve te fakulteteve/instituteve(ne slajde).
- Materialet baze sensibilizues-informues, qe do te paraqiten ne mbledhjet apo takimet qe do te organizohen me grupet e punonjesve te fakulteteve/instituteve dhe grupet e studenteve te fakulteteve (ne slajde).
- Planet kalendare te mbledhjeve apo takimeve qe do te organizohen me grupet e punonjesve te fakulteteve/instituteve dhe grupet e studenteve te fakulteteve.

### *1.2. Nivelet e aplikimit te sensibilizimit dhe grupet e personelit qe do te sensibilizohen*

Ne kuadrin e planifikimit te punes per kryerjen e Procesit PSI, te zgjedhjes dhe perpunimit te materialit baze sensibilizues-informues dhe te caktimit te kohes se kryerjes se takimeve apo mbledhjeve sensibilizuese, lind nevoja zgjidhjes se ketyre dy problemeve:

- Vendosja e niveleve te aplikimit te sensibilizimit te diferencuar ne piramiden e struktures organizative te UPT.
- Percaktimi i grupimeve te personelit brenda niveleve.

Ne zgjidhjen e ketyre dy problemeve duhet te kihen parasysh:

- Respektimi i parimit top-down ne aplikimin e sensibilizimit (sensibilizimi fillon nga maja dhe perfundon ne bazen e piramides), si nje praktike pozitive e linjes llogjike dhe te organizuar.
- Rritjen e rendimentit ne sensibilizim, duke shfrytezuar dhe rezultatet e aktivitetit 1.1.
- Struktura organizative e institucionit dhe mundesine e grupimeve minimale te mundshme dhe te justifikuar.

Aktiviteti do te kryhet nga anetaret e Grupit qendror.

Indikatori i performances se ketij aktiviteti do te jete: “Skema piramidale e sensibilizimit”

### *1.3 Format, llojet te instrumenteve sensibilizues dhe permbajtja e materialit sensibilizues*

Format dhe instrumentet sensibilizues nga njera ane dhe permbajtja e materialit sensibilizues nga ana tjeter jane probleme te cilet kane te bejne me efektivitetin dhe eficensen e Procesit PSI.

Ne zgjedhjen e formes dhe instrumenteve sensibilizues duhet:

- te njihen format dhe instrumentet sensibilizues me te perdorur dhe te analizohen ato;

- te zgjidhen format dhe instrumentet mbi baze te mundesive konkrete teknike dhe ekonomike qe disponohen;
- te diskutohen propozimet duke pare mundesine e unifikimit te tyre te tyre te argumentuar, te plote ose te pjesshem.

Permbajtja e materialit sensibilizues duhet te kete te beje kryesisht me:

- detyrimet ligjore qe rrjedhin nga Ligji “Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise”, Nr. 9741, Dt 21.05.2007;
- sloganin baze te fushates sensibilizuese dhe te gjithë periudhes se implementimit te Programit te cilesise ne UPT;
- konceptet baze te cilesise ne universitet dhe te akreditimit te cilesise;
- standardet europiane te sigurimit te cilesise ne arsimin e larte;
- thirrjet mobilizuese per pjesemarrje ne implementimin e projekteve te Programit te cilesise ne UPT.

Aktiviteti do te kryhet nga Grupi qendror dhe grupet e fakulteteve/instituteve/studenteve.

Indikatorët e performances se ketij aktiviteti do te jene:

- “Lista e formave dhe e llojeve te instrumenteve sensibilizues”.
- Skicat e materialet me permbajtje sensibilizuese (postera, etj.)

## **2. Aktivitetet e realizimit te Procesit PSI**

### *2.1 Realizimi i formave dhe instrumenteve sensibilizues*

Ky aktivitet duhet te kruhet pas realizimit te aktivitetit 1.3.

Paraqitja (kompozimi apo arkitektura) e formave dhe instrumenteve sensibilizues do te luaje nje rol te rëndesishem ne terheqjen e nevojshme te vemendjes, ndersa permbajtja e materialeve dhe cilesia dhe korrektesia e formulimit te tyre do te ndikoje drejtperdrejt ne nivelin e kerkuar te njohjes dhe sensibilizimit.

Realizimi i formave dhe instrumenteve sensibilizues do te kryhet nga Grupi qendror dhe grupet e fakulteteve/instituteve.

Indikatorët e performances se ketij aktiviteti do te jene:

- Kendet e cilesise prane çdo fakulteti/instituti.
- Materialet konkrete sensibilizues te paraqitura ne forma apo instrumente te ndryshem sensibilizues.

### *2.2 Realizimi i takimeve apo mbledhjeve sensibilizuese*

Takimet apo mbledhjet duhet te realizohen ne datat dhe oret e fiksuara ne planet kalendare te mbledhjeve apo takimeve qe do te organizohen me grupet e punonjesve te fakulteteve/instituteve dhe grupet e studenteve te fakulteteve.

Serioziteti i drejtimit dhe zhvillimit, sasia dhe cilesia e informacionit sensibilizues qe do te tranzmetohet dhe kohezgjatja optimale e aktivitetit do te jene faktore vendimtare ne arritjen e sensibilizimit te kerkuar.



Realizimi i takimeve apo mbledhjeve do te kryhet sipas ketij rendi veprimesh baze:

- Garantimi i ambientit (salles) te pershtatshem ku do te kryhet aktiviteti sensibilizues.
- Lajmerimi me pergjegjesi i pjesemarresve.
- Drejtimi i takimit apo mbledhjes nga kryetari i grupit sensibilizues perkates (Rektori/dekani/drejtori); fjala e rastit do te mbahet nga zv.dekani/nendrejtori.
- Njoftimi per ngritjen e Kendit te Cilesise.

Indikatorët e performances se ketij nenaktiviteti do te jene:

- Pjesemarrja, drejtimi i takimit dhe pergatitja e realacionit perkates te aktivitetit nga dekani/drejtori.
- Numri i pjesemarresve ne takimin apo mbledhjen sensibilizuese.

### **3. Aktivitetet e kontrollit te realizimit te Procesit PSI**

Gjate kryerjes se kontrolleve te realizimit te Procesit PSI duhet te kihet parasysh efektet e ketyre dy parimeve baze te kontrollit:

- evidentimi i parregullsive apo jo konformiteteve;
- parandalimi i jokonformiteteve ne kontrollet e ardhme (duke kujtuar se procesi i sensibilizimit me te gjithë aktivitetet qe shprehin menaxhimin e tij do te vazhdoje gjate gjithë periudhes se implementimit te Programit).

Format dhe koha e kontrollit te aktiviteve dhe nenaktiviteve duhet te zgjidhen ne baze te rendesise, lloit dhe natyres se aktivitetit/nenaktivitetit qe do te kontrollohen.

#### ***3.1 Kontrolli i aktiviteve te planifikimit te Procesit PSI***

Aktiviteti do te kryhet gjate dhe pas kryerjes se aktiviteve 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Ky kontroll do te kryhet duke evidentuar parregullsite e mundshme dhe duke nderhyre per menjanimin e tyre.

Aktiviteti i kontrollit do te kryhet nga anetaret e Grupit qendror, nen kryesine e Rektorit te UPT.

Indikator i ketij aktiviteti do te jete: “Evidenca e kontrollit te planifikimit te Procesit PSI”

#### ***3.2 Kontrolli i aktiviteve te realizimit te Procesit PSI***

Ky kontroll do te kryhet gjate dhe pas kryerjes se aktiviteve 2.1 dhe 2.2.

Aktiviteti i kontrollit do te kryhet nga anetaret e Grupit qendror, nen kryesine e Rektorit te UPT.

Indikator i ketij aktiviteti do te jete: “Evidenca e kontrollit te realizimit te Procesit PSI”

### **4. Veprimet permiresuese pas realizimit te Procesit PSI**

#### ***4.1 Analiza e rezultateve te kontrollit***

Aktiviteti kryhet pas aktivitetit 3.1 dhe 3.2.

Pas realizimit të Procesit PSI duhet të kryhet një analizë e plotë, objektive dhe me përgjegjësi e rezultateve që kanë dhënë kontrollet e ushtruara gjatë dhe pas kryerjes së aktiviteteve apo nëaktiviteteve të Procesit PSI. Kjo analizë synon krijimin e mundësive për njohjen e gjendjes për të vazhduar me të njëjtin aktivitetin 4.2.

Analiza do të bëhet nga grupi qendror dhe nga të gjithë grupet e fakulteteve/instituteve dhe studenteve.

Indikatorët e performancës do të jenë: “Proces verbalët e mbledhjeve për analizën e përfundimit të Procesit PSI dhe për masat përmirësuese”.

#### *4.2 Ndermarrja e veprimeve korrigjuese dhe parandaluese*

Aktiviteti do të jetë vazhdim i aktivitetit 4.1.

Mbi bazën e rezultateve të analizës së mesipërme duhet të evidentohen dhe ndërmerren dy grupet e masave përmirësuese:

- masat korrigjuese, dhe
- masat parandaluese.

Aktiviteti do të kryhet nga Grupi qendror, nën kryesinë e Rektorit.

Masat përmirësuese synojnë përmirësimin e plotë të gjendjes së sensibilizuar dhe parandalimin i jokonformiteteve përkatëse, meqenëse sensibilizimi do të vazhdojë edhe gjatë implementimit të projekteve të Programit. Këtu masa do t'i komunikohen grupeve të fakulteteve/instituteve dhe të studenteve, për të kryer ndërhyrjet përkatëse, duke parashikuar dhe realizuar verifikimin e realizimit të tyre përfundimtar.

Indikatorët e këtij aktiviteti do të jenë: “Proces verbalët e mbledhjeve për analizën e përfundimit të Procesit PSI dhe për masat përmirësuese”.

**DOKUMENTE PERMBLEDHES**

## KUADRI LOGJIK I PROCESIT PSI

OBJEKTIVI I PERGJITHSHEM	MAKROATIVITETET E PROCESIT PSI	AKTIVITETET E PROCESIT PSI	OBJEKTIVAT SPECIFIKE	INDIKATORET E PERFORMANCES
Realizimi i sensibilizim-informimit te nevojshem me te gjithë masen e personelit te UPT dhe te gjithë masen e studenteve te ketij institucioni	1. Planifikimi i Procesit PSI	1.1 Grupet e realizimit te Procesit PSI	Krijimi dhe trainimi i grupeve qe do te realizojne sensibilizim-informimit	Skema e grupeve te trainuar sensibilizues Dy materialet e dy seminareve sensibilizuese
		1.2. Nivelet e aplikimit te sensibilizimit dhe grupet e personelit qe do te sensibilizohen	Krijimi i mundesise per ndarjen organizative te punes sensibilizuese	Skema piramidale e sensibilizimit
		1.3 Format, llojet e instrumenteve sensibilizues dhe permbajtja e materialit sensibilizues	Percaktimi i formave, instrumenteve dhe i permbajtjes se materialit sensibilizues	Lista e formave dhe instrumenteve sensibilizues
	2. Realizimi i Procesit PSI	2.1 Realizimi i formave dhe instrumenteve sensibilizues	Krijimi i baze reale te sensibilizim-informimit	Deklarata Sensibiliz. e Rektoratit Kendet e Cilesise me materialet sensibilizues-informues Tete materialet e takimeve sensibilizuese Faqja UPT ne internet
		2.2 Realizimi i takimeve apo mbledhjeve sensibilizuese	Krijimi i sensibilizimit kolektiv	Pjesemarrja e titullareve kryesore Numri i pjesemarrsesve ne takime apo mbledhje Relacioni i realizimit te aktivitetit
	3. Kontrolli i aktiviteve te Procesit PSI	3.1 Kontrolli i aktiviteve te planifikimit te Procesit PSI	Evidentimi i rregullsise se planifikimit te Procesit PSI	Evidenca e kontrollit te planifikimit te Procesit PSI
		3.2 Kontrolli i aktiviteve te realizimit te Procesit PSI	Evidentimi i konformitetit te realizimit te Procesit PSI me planifikimin e tij	Evidenca e kontrollit te realizimit te Procesit PSI
	4. Veprimet permiresuese pas realizimit te Procesit PSI	4.1 Analiza e rezultateve te kontrollit	Krijimi i mundesise per njohjen e gjendjes pas realizimit te Procesit PSI	Proces verbalet e mbledhjeve per analizen e perfundimit te Procesit PSI dhe per masat permiresuese
		4.2 Ndermarrja e veprimeve korrigjuese dhe parandaluese	Permiresimi i plote i gjendjes se sensibilizuar dhe parandalimi i jokonformiteve perkatese	Proces verbalet e mbledhjeve per analizen e perfundimit te Procesit PSI dhe per masat permiresuese

*PLANI KALENDAR I REALIZIMIT TE AKTIVITETEVE TE PROCESIT PSI*

Nr. AKT.	KOHA EMERTIMI I AKTIVITETIT	DHJETOR 2008				JANAR 2009				SHKURT 2009				MARS 2009			
		JAVET															
		I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
1.1.1	Krijimi i grupeve sensibilizuese																
1.1.2	Trainimi i grupeve sensibilizuese																
1.2	Nivelet e aplikimit te sensibilizimit dhe grupet e personelit qe do te sensibilizohen																
1.3	Format, llojet te instrumenteve sensibilizues dhe permbajtja e materialit sensibilizues																
2.1	Realizimi i formave dhe instrumenteve sensibilizues																
2.2	Realizimi i takimeve apo mbledhjeve sensibilizuese																
3.1	Kontrolli i aktiviteve te planifikimit te Procesit PSI																
3.2	Kontrolli i aktiviteve te realizimit te Procesit PSI																
4.1	Analiza e rezultateve te kontrollit																
4.2	Ndermarja e veprimeve korrigjuese dhe parandaluese																

*EVIDENCA E REALIZIMITI DHE KONTROLLIT TE AKTIVITETEVE TE PROCESIT PSI*

<b>NR. AKT.</b>	<b>EMERTIMI I AKTIVITETIT</b>	<b>CILI DO TA REALIZOJE</b>	<b>CILI DO TA KONTROLLOJE</b>	<b>VEREJTJE</b>
1.1.1	Krijimi i grupeve sensibilizuese			
1.1.2	Trainimi i grupeve sensibilizuese			
1.2	Nivelet e aplikimit te sensibilizimit dhe grupet e personelit qe do te sensibilizohen			
1.3	Format, llojet te instrumenteve sensibilizues dhe permbajtja e materialit sensibilizues			
2.1	Realizimi i formave dhe instrumenteve sensibilizues			
2.2	Realizimi i takimeve apo mbledhjeve sensibilizuese			
3.1	Kontrolli i aktiviteve te planifikimit te Procesit PSI			
3.2	Kontrolli i aktiviteve te realizimit te Procesit PSI			
4.1	Analiza e rezultateve te kontrollit			
4.2	Ndermarrja e veprimeve korrigjuese dhe parandaluese			

*LIST-PAGESA E KONTRIBUESVE NE AKTIVITETET E PROCESIT PSI*

N.r.	EMRI dhe MBIEMRI i KONTRIBUESIT	EMERTIMI i DETYRAVE TE KRYERA	PERIUDHA KOHORE	KOHA e PUNES	TARIFA ORARE	SHUMA e PAGESES
<b>SHUMA TOTALE</b>						

*LIST-SHPENZIME NE AKTIVITETET E PROCESIT PSI*

NR	EMERTIMI I SHPENZIMIT	NJESIA KRYESORE MESIMORE SHKENCORE	SASIA	ÇMIMI	SHUMA E SHPENZIMIT
<b>SHUMA TOTALE</b>					



***EVIDENCA E REALIZIMITI DHE KONTROLLIT TE AKTIVITETEVE TE PROCESIT PSI***

<b>NR. AKT.</b>	<b>EMERTIMI I AKTIVITETIT</b>	<b>CILI DO TA REALIZOJE</b>	<b>CILI DO TA KONTROLLOJE</b>	<b>VEREJTJE</b>
1.1.1	Krijimi i grupeve sensibilizuese	Rektori: akademik. J. KAÇANI Kon. Cilesise Prof. Dr. P.DEÇOLLI	Rektori: Akademik Jorgaq KAÇANI	
1.1.2	Trainimi i grupeve sensibilizuese	Kon. Cilesise. Prof. Dr. P.DEÇOLLI	Rektori: Akademik Jorgaq KAÇANI	
1.2	Nivelet e aplikimit te sensibilizimit dhe grupet e personelit qe do te sensibilizohen	Rektori: Akademik J. KAÇANI Kon. Cilesise Prof. Dr. P.DEÇOLLI	Rektori: Akademik Jorgaq KAÇANI	
1.3	Format, llojet te instrumenteve sensibilizues dhe permbajtja e materialit sensibilizues	Rektori: Akademik J. KAÇANI Kon. Cilesise Prof. Dr. P.DEÇOLLI	Rektori: Akademik Jorgaq KAÇANI	
2.1	Realizimi i formave dhe instrumenteve sensibilizues	Grupi sensibilizues i rektoratit Kancelari i UPT, kancelaret e fakulteteve/instituteve Grupet sensibilizuese te fakulteteve/instituteve Kon. Cilesise Prof. Dr. P.DEÇOLLI	Zv. Rektori Prof. As. Akli Fundo Zv. Rektore Prof. Dr. Rozeta Mitrushu Kon. Cilesise Prof. Dr. P.DEÇOLLI	
2.2	Realizimi i takimeve apo mbledhjeve sensibilizuese	Grupi sensibilizues i rektoratit Grupet sensibilizuese te fakulteteve/instituteve Grupi i Keshillit Studentor	Grupi sensibilizues Qendror	
3.1	Kontrolli i aktiviteve te planifikimit te Procesit PSI	Grupi sensibilizues Qendror	Rektori: Akademik Jorgaq KAÇANI	
3.2	Kontrolli i aktiviteve te realizimit te Procesit PSI	Grupi sensibilizues Qendror	Rektori: Akademik Jorgaq KAÇANI	
4.1	Analiza e rezultateve te kontrollit	Grupi sensibilizues Qendror	Rektori: Akademik Jorgaq KAÇANI	
4.2	Ndermarja e veprimeve korigjuese dhe parandaluese	Grupi sensibilizues Qendror	Rektori: Akademik Jorgaq KAÇANI	

